

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar

"ZED Amper" sh.p.k

Mbështetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij Akt Themelimi ortakët:

Z. Dritan Zika, i biri i Esat, i datëlindjes 31.01.1970, lindur në Shijak, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi Shqipëtare, identifikuar me Nr. ID H00131041R, me adresë Rruga Hamalle, H.4, Hamallaj, Njësia Sukth, Durrës.

Z. Klito Zika i biri i Ermir, i datëlindjes 16.10.1997, lindur në Manëz, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi Shqipëtare, identifikuar me Nr. ID J71016069F, me adresë Rruga Rilindja H. 6, Hamallaj, Njësia Sukth, Durrës.

Z. Erjon Zika i biri i Esat, i datëlindjes 19.07.1982, lindur në Shijak, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi Shqipëtare, identifikuar me Nr. ID I20719080W, me adresë Rruga Hamalle, H.4, Hamallaj, Njësia Sukth, Durrës.

Z. Agim Zika i biri i Kujtim, i datëlindjes 21.05.1993, lindur në Elbasan, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi Shqipëtare, identifikuar me Nr. ID J30521062G, me adresë Rruga "Kadri Gani", Nd.19, H. 1, Elbasan 3001.

Vendosën të krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"ZED Amper" sh.p.k** me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Emërtimi dhe Forma

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **"ZED Amper" sh.p.k.** referuar më poshtë Shoqëria. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar në fuqi, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit të vendit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.



Neni 2

Selia e Shoqërisë

2.1 Selia e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"ZED Amper" sh.p.k** do ketë selinë në adresën, Rruga Rilindja H. 6, Hamallaj, Njësia Sukth, Durrës.

2.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 3

Objektivi i Veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar në fushat e:

- Instalime elektrike në objekte të ndryshme civile dhe industriale.
- Riparime elektrike në objekte të ndryshme civile dhe industriale.
- Instalime të paneleve industriale.
- Ndërtim dhe rikonstrukcion për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e elektrike të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët si dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Ndërtim i impianteve dhe sistemeve për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në ulët, të mesëm e të lartë.
- Ndërtim i impianteve hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre.
- Ndërtim i impianteve të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, sisteme CCTV, alarm, intruder etj.
- Import-eksport, tregtimin me shumicë dhe pakicë të të gjithë artikujve industriale, kabllorë, telave (baker, alumin) elektrike, pajisjeve, elektrike.

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë dhe për cfardolloj shkak.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë



5.1 Kapitali fillestar i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “ZED Amper” sh.p.k do të jetë në vlerën 1 000 000 (nje milion) lekë, në 4 (katër) kuota.

5.2 Kuotat e kapitalit fillestar zotërohen si më poshtë:

- 1- Ortaku themelues Dritan Zika, identifikuar me Nr. ID H00131041R, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 250 000 (dyqind e pesedhjetë mijë) lekë, që përbën 25% të kapitalit themeltar.
- 2- Ortaku themelues Klito Zika, identifikuar me Nr. ID J71016069F, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 250 000 (dyqind e pesedhjetë mijë) lekë, që përbën 25% të kapitalit themeltar.
- 3- Ortaku Erjon Zika, identifikuar me Nr. ID I20719080W, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 250 000 (dyqind e pesedhjetë mijë) lekë, që përbën 25% të kapitalit themeltar.
- 4- Ortaku Agim Zika, identifikuar me Nr. ID J30521062G, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 250 000 (dyqind e pesedhjetë mijë) lekë, që përbën 25% të kapitalit themeltar.

5.3 Kapitali fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar) sipas parashikimeve në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe atyre të Statutit të shoqërisë.

5.4 Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të hapi llogari në cdo bankë të njohur me ligj.

Neni 6

Drejtimi i Shoqërisë

6.1 Shoqëria do të drejtohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.

6.2 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është jo më shumë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit.

6.3 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimeve në statutin e shoqërisë.

Neni 7

Kompetencat e Administratorit



7.1 Administratorit i njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, parimet e biznesit, dhe vendimet e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë.

7.2 Nëse zgjidhet më shumë se një administrator ata kanë të drejtë të veprojnë sëbashku ose secili më vete.

Neni 8

Ortakët themelues kanë të drejtë të caktojnë financiere, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të paguajnë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Emërimi i parë i Administratorit

Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare (pesë) nga data e themelimit, emërohet:

Z. Erjon Zika i biri i Esat, i datëlindjes 19.07.1982, lindur në Shijak, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me kombësi dhe shtetësi Shqipëtare, identifikuar me Nr. ID I20719080W, me adresë Rruga Hamalle, H.4, Hamallaj, Njësia Sukth, Durrës.

Neni 10

Shoqëria ka vulen e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për aktivitetin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i Themelimit u përpilua në 4 (katër) kopje origjinale, për t'ju shpërndarë organeve kompetente.



Sot me date 1.02.2025, Akti i Themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

Ortakët themelues të

"ZED Amper" sh.p.k

Dritan ZIKA

Dritan Zika


Erjon ZIKA

Erjon Zika



Klito ZIKA

Klito Zika


Agim ZIKA

Agim Zika

